

VENDIM Nr. 92/2017

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIKËS DHE
KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË PERSONELIT TË KOLEGJIT
TË POSAÇËM TË APELIMIT**

(ndryshuar me vendimin nr. 101/2018, datë 4.10.2018 dhe 82/2020, datë 23.12.2020; nr. 35/22, datë 12.5.2022)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës, si dhe të neneve 18, pika 1, dhe 29 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

II. Organika dhe klasifikimi i pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit është sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

III. Struktura organizative e personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit është sipas lidhjes nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 29.9.2017

Lidhja nr. 1

**ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË KOLEGJIT TË POSAÇËM TË
APELIMIT**

(ndryshuar me vendimin nr. 101/2018, datë 4.10.2018 dhe 82/2020, datë 23.12.2020; nr. 35/2022, datë 12.5.2022)

FUNKSIONI ORGANIK

Klasifikimi i pagës

Numri

(2)

I. KRYETAR	G3*	1
Sekretar		1
	Sekretar në kabinetin e kryetarit të Kuvendit**	
II. KOLEGJI I GJYQTARËVE		(6)
Gjyqtarë	G3*	6
III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR		(25)
Këshilltarë juristë	80% e pagës G3*	14
Këshilltarë ekonomistë	80% e pagës G3*	11
IV. SEKRETAR I PËRGJITHSHËM	I-a	1
V. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIEN DHE PUBLIKUN		(14)
Drejtor	II-b	1
Specialist sekretarie gjyqësore	III-b	5
Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve	III-b	2
Përkthyes	II-b	4
Koordinator për medien dhe marrëdhëniet me jashtë	III-a	1
Specialist pritjeje me popullin	III-b	1
VI. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		(9)
Drejtor	II-b	1
Specialist financë/buxhet	III-b	1
Specialist i burimeve njerëzore	III-b	1
Specialist IT ***	III-b	2
Specialist protokolli/arkivi ****	III-b	1
Magaziniyer	VI	1
Punonjës pastrimi	II	1
Shofer/korrier	V	1
TOTAL		57

* Sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

** Kategoria e pagës për sekretarin e kryetarit është sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

*** Punonjësit në pozicionin e specialistëve të teknologjisë së informacionit përfitojnë shtesën për natyrë të veçantë pune në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

**** Punonjësit në pozicionet specialist arkivi, përfitojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin sipas kushteve dhe masës së përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

***** Përfitimet për kushte të vështira e të dëmshme të shëndetit për punonjësit mbështetës janë sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore

Lidhja nr. 2

STRUKTURA ORGANIZATIVE E KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT
(ndryshuar me vendimin nr. 101/2018, datë 4.10.2018 dhe 82/2020, datë 23.12.2020; nr. 35/2022,
datë 12.5.2022)

